



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Për:	Artan Ahmeti , Sekretar I Përgjithshëm në Ministrinë e Financave, Punës dhe Transfereve	
Kopje:	Kryetari i Komunës së Malishevës Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës Njësia për Administrimin e Dokumenteve në MAPL	
Përmes:	Jeton Qela , Sekretar i Përgjithshëm në MAPL	
Nga:	Erblin Hetemi , Drejtor i Departamentit Ligjor në MAPL	Datë: 21.01.2026 020-51
Zyrtarët përgjegjës:		
1. Zyrtari konfirmues i vlerësimit ligjor	Xhevat Tafa , Udhëheqës i Divizionit për Shqyrtimin e Ligjshmerisë së Akteve të Komunës dhe Akteve të Kryetarit	
2. Zyrtari hartues i vlerësimit ligjor	Donjeta Cakolli , Zyrtare e Lartë për Shqyrtimin e Ligjshmerisë së Akteve të Komunës	
Lënda:	Shkresë përcjellëse për MFPT	
Lloji i aktit:	Vendim	

I nderuar Sekretar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, ka pranuar vendimin Nr.02/17 të datës 20.01.2026 për miratimin e buxhetit të komunës së Malishevës për vitin 2026-2028, i miratuar nga Kuvendi i Komunës së Malishevës dhe i nënshkruar nga Kryesuesi i Kuvendit të Komunës së Malishevës, me qëllim të shqyrtimit të detyrueshëm të ligjshmerisë, ashtu siç parashihet me nenin 81 të ligjit Nr. 03/L-040 Për Vetëqeverisje Lokale.

Duke u bazuar në nenin 9 të Ligjit Nr. 08/L-284 Për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, nenin 3 të Rregullores (QRK) Nr.06/2021 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Rregullores (QRK) Nr. 10/2019 për Shqyrtimin Administrativ të Akteve të Komunave, si institucion përgjegjës po ju dërgojmë për shqyrtimin e ligjshmerisë, aktin e komunës si në vijim:

Vendimi Nr.02/17 të datës 20.01.2026 për miratimin e buxhetit të komunës së Malishevës për vitin 2026-2028.

I miratuar më datë: 20.01.2026

I parashtruar për shqyrtim në MAPL më datë: 21.01.2026



HYRËSE - ULAZNA - INCOMING
REPUBLIC OF KOSOVO / REPUBLIKA E KOSOVËS
MINISTRIA E ADMINISTRIMIT TË PUSHTETIT LOKAL
Country of Local Government Administration

Date: 21.01.2026
Date: 21.01.2026

Shkronja organizatvive	Nr. i Lendes	Vlera
-VI-	020-51	

REPUBLIKA E KOSOVËS
KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

21/01/2026
02/17

Kuvendi i Komunës
Nr.02/

Date: 20.01.2026

Në bazë të nenit 11, nenit 12 paragrafi 2 pika (d), nenit 17, nenit 24 nenit 40 paragrafi 2 pika (b), të Ligjit nr. 03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës" nr.28/15, qershor 2008), nenit 61 të Ligjit nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësi ("Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 27/03 qershor 2008"), bazuar në nenin 13, nenin 23 paragrafi 7 pika (b), nenin 42 dhe 43, të Statutit të Komunës së Malishevës nr.02/441 të datës: 14.09.2023, kërkesën nr.04/534 datë: 29.08.2025 të Kryetarit të Komunës, Kuvendi i Komunës së Malishevës në mbledhjen e II- (dytë) të jashtëzakonshme, të mbajtur me datë: 20.01.2026 merr këtë:

V E N D I M

PËR MIRATIMIN E BUXHETIT TË KOMUNËS SË MALISHEVËS PËR VITIN 2026-2028

1. Miratohet Buxheti i Komunës së Malishevës për vitet 2026-2028, me theks të veçantë, për vitin 2026 i propozuar sipas kërkesës nr.04/534 datë 29.08.2025 nga Kryetari i Komunës së Malishevës.

2. Bazuar në pikën e 1 të këtij vendimi, Buxheti i Komunës së Malishevës i miratuar për vitin 2026-2028, me theks të veçantë për vitin 2026 do të jetë i shprehur në këta zëra buxhetorë:

Paga dhe medijtje.....	13,077,454.00€
Mallra dhe shërbime.....	2,555,812.00€
Komunali.....	500,000.00€
Subvencione dhe transfere.....	600,000.00€
Investime kapitale.....	5,355,444.00€
Totali :	22,088,710.00€

3. Buxheti i aprovuar për vitet 2026-28, është bazuar në Qarkoren Buxhetore 2026/1 dhe 2026/2 për Komunitat, lëshuar nga Ministri i Financave, Punës dhe Transfereve.

4. Pjesë përbërëse e këtij vendimi janë tabelat e planit të buxhetit dhe lista e projekteve kapitale për vitet 2026-2028, me theks të veçantë për vitin 2026

5. Për zbatimin e këtij vendimi do të kujdeset Kryetari i Komunës, përmes Drejtorisë për Ekonomi, Financa dhe Buxhet.

5. Pas miratimit nga ana e Kuvendit të Komunës së Malishevës, ky vendim hynë në fuqi 15 ditë pas dërgimit në autoritetin mbikëqyrës, konform nenit 81 të Ligjit nr.03/L-040 për Vetëqeverisjen Lokale, "Gazeta zyrtare e Republikës së Kosovës", Nr.28.2008, nenit 8, lidhur me nenin 9 të Rregullores (QRK) nr.06.2021, dhe pas shpalljes në web-faqen e Komunës.

Vendimi ju dërgohet:

Ministrit të Financave, Punës dhe Transfereve

Ministrit të Administrimit të Pushtetit Lokal

Arkivit të Komunës

